

FJALA E DEPUTETIT PETRIT VASILI

E ENJTE DATA 22 QERSHOR 2023

E nderuar zonja drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë deputetë,

Pa as më të voglin diskutim, mund të themi se jemi në ditën e raportimit të një institucioni të pavarur që i vendos këtë institucion dhe Kuvendin e Shqipërisë në një nga raportet më qesharake dhe më dramatike që mund të ekzistojë. Mandati i Avokatit të Popullit ka përfunduar më 20 qershor të vitit 2022. Sot jemi më 22 qershor të vitit 2023 dhe për një vit rresht për shkak të tregut, pazarit politik, vendosjani emrin si të doni, sepse nuk ka shpjegim tjetër, ky mandat nuk është rifreskuar, ashtu sikurse e kërkon Kushtetuta. Pra, është e drejtë e qytetarëve që të kenë një Avokat Populli të zgjedhur në mënyrë korrekte, ashtu siç e kërkon Kushtetuta, por ne nuk e kemi. Çfarë buron nga kjo, thjesht një vonesë e zakonshme?! Jo, nuk është një vonesë e zakonshme, por, siç e thashë, është për shkak të pazareve. Pikërisht për këtë gjë në kohën kur bëhej reforma në drejtësi, të paktën ta kujtojmë pak si diskutim, sepse vetë reforma në drejtësi është në një përshpirtje të plotë, Komisioni i Venecies thoshte shumë qartë që tejzgjatja e mandateve të organeve kushtetuese, krijon shteg për thyerjen e pavarësisë së tyre. Pra, krijon atë që është varësi politike, e ashtuquajtura varësi dhe mirënjohje politike, sepse “jemi ne që të zgjodhëm dhe jo ata”, për pasojë edhe objektiviteti i institucionit merr fund. Këtu nuk është në gjendje asnjëri të japë më shumë shpjegime dhe ta shpëllajë Kuvendin e Shqipërisë nga ky turp kushtetues dhe procedural. Dikush do të thotë me qetësinë më të madhe se ky Kuvend u mësua të bashkëjetojë më turpet, pra është për atë pjesë që është autore e tyre, jo për ne. Për sa i përket veprimtarisë së Avokatit të Popullit, pa asnjë diskutim, përgjithësisht të gjitha raportet e Avokatit të Popullit, formalisht, siç thotë populli, në letra, pak kanë pasur për të kritikuar. Problemi është që, në raport me një sfond të përbindshëm të shkeljeve të të drejtave të qytetarëve, të të gjitha llojeve të formave, të lirisë së pronës, të lirisë së shprehjes, të së drejtës për të marrë drejtësi e të tjera, diferenca është një humnerë e vërtetë. Ajo që duhet të kishim në terren, do të ishte një Avokat i Popullit, që donte apo nuk donte, do të ishte ndryshe, nuk do të ishte si një vend tjetër, ku Kushtetuta dhe ligji mbretërojnë, por do të ishte i imponuar të kishte një protagonizëm shumë më të fortë, sepse nuk ka kush ta mbrojë më. Ne kemi parë e shikojmë se si në institucionet e paraburgimit nuk është 1, por janë 1, 2, 3 e me radhë të rinj që humbin jetën. Kjo është një situatë skandaloze që nuk ka ku të shkojë më, pra ka hyrë në kufijtë e krimin.

Kemi parë se si sa hap e mbyll sytë ndryshohen kodet në Shqipëri, por kemi parë projektligje, siç thotë kolegu Shehu, për drogën (ende nuk kanë ardhur), që është akoma më dramatike, një tragjedi e vërtetë shëndetësore dhe sociale. Njëherazi ka edhe shumë çështje të tjera të mëdha, për shkak të kapjes së Gjykatës Kushtetuese, për fat të keq. Duhej të ishte detyrë e Avokatit të Popullit që të merrte misionin për të çuar atje ligje tmerrësisht antikushtetuese, sepse kjo gjykatë e kapur, sigurisht, i ka nxjerrë bojën moslegjitimitit të palëve, pra marrjes përsipër që as të mos i lejojë palët të ankohen, qofshin parti politike, organizata joqeveritare, subjekte private, subjekte biznesi e të tjera. Pra, normalisht është e qartë që duhet dhe është e imponuar që të kishim një rol të ri të Avokatit të Popullit, ku fizibiliteti i tij duhej të ishte dukshëm shumë më i madh, sepse qytetarët kanë shumë

nevojë për të. Asnjë nuk do ta kritikonte Avokatin e Popullit, kurrën e kurrës, për një protagonizëm të shtuar, përkundrazi, të gjithë do ta kërkonim dhe do të ishim solidarë me të kushdo që ta sulmonte, sepse dihej që pala që do ta sulmonte, do të ishte qeveria. Pra, ne jetojmë në ditët më të këqija dhe më të zeza të shkeljes së të drejtave të njeriut. Mjafton të mendojmë hartën e re gjyqësore, e cila e bëri të pamundur edhe marrjen formale të drejtësisë dhe jo më elemente të tjera. Në këtë pikëpamje, duke qenë i ftohtë dhe indiferent ndaj raportimit të radhës, sërish them se duhet të heqim turpin e një viti vonesë dhe njëherazi t'i japim Avokatit të Popullit atë protagonizëm për të cilin qytetarët kanë nevojë dhe askush tjetër nuk mund t'ua japë dot. Faleminderit!